



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

Data: 31 Janar 2019

Njoftim

Lehtësime ligjore për personat me të ardhura më të larta të cilët, në vend që të paguajnë kontribute të domosdoshme shëndetësore në bazën aktuale prej 100%, do të paguajnë kontribute në bazë 50% nga paga mesatare, pa qenë nevoja të vijnë në Fond

Në pajtueshmëri me Ligjin për kontributet e domosdoshme të sigurimit shoqëror, Fondi për sigurim shëndetësor për çdo vit në fillim të muajit Shkurt, i publikon limitet e të ardhurave të realizuara për arsye të regjistrimit/ reregjistrimit të personave me të ardhura të ulta dhe të larta, me qëllim që personat të kenë vazhdimësi të sigurimin shëndetësor.

Ashtu si vitin e kaluar, edhe këtë vit vazhdon reregjistrimi i kësaj kategorie të siguarish në mënyrë automatike andaj, Njoftojmë personat me të ardhura të ulta / larta se nuk do të ketë nevojë të vijnë nëpër sportelet e Njërive rajonale të Fondit për t'i deklaruar të ardhurat pasi sigurimi shëndetësor i tyre do të vazhdojë në mënyrë automatike, përjashtuar të siguarit që kanë ndryshime në të ardhurat e tyre.

Limitet e reja për sigurim shëndetësor në pajtueshmëri me të ardhurat e realizuara neto në vitin 2018 janë:

- Deri 145.980 denarë – sigurimin shëndetësor e mbulon shteti respektivisht, Ministria e shëndetësisë;
- Prej 145.980 deri 216.102 denarë, nëse në dy muajt e fundit kanë realizuar të ardhura më të ulëta se 24.330 denarë – sigurimin shëndetësor e mbulon shteti respektivisht, Ministria e shëndetësisë;
- Prej 145.980 deri 216.102 denarë – sigurimin shëndetësor e paguan vetë i siguruari në vlerë prej 50% të pagës mesatare respektivisht, 1.333 denarë në muaj;
- Mbi 216.102 denarë – sigurimin shëndetësor e paguan vetë i siguruari në vlerë prej 50% të pagës mesatare respektivisht, 1.333 denarë në muaj.

Potencojmë se, të ardhurat e realizuara brenda familjes konsiderohen të ardhurat personale të bartësit dhe të ardhurat e anëtarëve tjerë të familjes (bashkëshortit/bashkëshortes, fëmijëve).

Risirë në rregulloret ligjore

Me ndryshimet dhe shtesat në Ligjin për kontributet e domosdoshme të sigurimit shoqëror, të publikuar në Gazetën Zyrtare të RM nr. 247 nga data 31.12.2018, personat me të ardhura të larta nuk do të kenë për obligim të paguajnë kontribute për sigurim të domosdoshëm shëndetësor në vlerë 100% bazë nga paga



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

mesatare por do të paguajnë 50% nga paga mesatare në RM, e publikuar në Janar të vitit aktual. Këtë përfitim ligjor do ta shfrytëzojnë 462 të siguruar.

Të siguruarit që kanë Vendim aktual të paguajnë kontribute bazë 100% për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve, ndërsa ajo është paga mesatare në RM e publikuar në Janar të vitit aktual, sipas të dhënave nga Enti shtetëror i statistikës, personat në fjalë sipas detyrës zyrtare do të reregjistrohen dhe do të pranojnë Vendime të reja me anë të së cilës do të riobligohen të paguajnë bazë të re të kontributeve të ulur për 50% nga paga mesatare. Kështu, të siguruarit në fjalë nuk do të ketë nevojë të vijnë nëpër sportelet e Njësive rajonale të Fondit.

Personat të cilët do të bëjnë kërkesë të re për t'a përcaktuar statusin e personit të siguruar nga data 1 Shkurt 2019, në pajtim me nenin 5, alienenë 2 nga Ligji për sigurim shëndetësor respektivisht, tek formulari 'BOL-N' tek pjesa 'persona me të ardhura më të larta' do ta rrumbullakësojnë pikën '2', do të pranojnë Vendim me të cilin do të obligohen të paguanë kontribute për sigurim shëndetësor në vlerë 50% nga paga mesatare.

Mënyra e regjistrimit/riregjistrimit të personave me të ardhura të ulta / larta, për të cilët nuk ka ndryshime ligjore

Personave të cilëve sigurimi shëndetësor do t'ju vazhdojë në mënyrë automatike dhe që nuk kanë ndryshime sa i përket limitit të të ardhurave të realizuara, nuk do të pranojnë Vendime të reja nëpërmjet postës.

Personat të cilët për së pari herë kanë aplikuar për sigurim shëndetësor në muajt Janar 2019, do të duhet të vijnë sërish në sportelet e Njësive rajonale të Fondit për t'u paraqitur prej datës 1 Shkurt deri në 31 Mars 2019, në pajtueshmëri me limitet e reja Ligjore të posa publikuara pasi të njejtat për vitin 2018 janë rritur, me qëllim që personat në fjalë t'a gëzojnë të drejtën e sigurimit shëndetësor.

Personat të cilët kanë ndryshime në nivelin e të ardhurave neto për vitin 2018, është e nevojshme që t'i sjellin dokumentet në sportelet e Njësive rajonale të Fondit nga data 1 Shkurt deri në 31 Mars, për t'a bërë reregjistrimin.

Nëse konstatohet se i siguruari i takon kategorisë së personave me të ardhura më të larta, por nuk i ka deklaruar të ardhurat dhe ndërkohë ka shfrytëzuar shërbime shëndetësore, Fondi sipas detyrës zyrtare do të sjellë Vendim për t'a ndërprerë statusin e sigurimit shëndetësor për personin në fjalë duke i'u shkurtuar e drejta e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, përveç të drejtës për shfrytëzimin e ndihmës urgjente. Personave në fjalë që nuk do t'ju vazhdohet sigurimi shëndetësor shkaku i të ardhurave më të larta nga limitet e përcaktuara, do të duhet të vijnë në hapësirat e Njësive rajonale të Fondit që ta rregullojnë statusin e sigurimit shëndetësor.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk

Për informata më të detajuara lidhur me Projektin për regjistrimin/ reregjistrimin e personave të pa punë, të siguruarit mund të informohen çdo ditë pune duke u lajmëruar në **linjën telefonike pa pagesë 0800 33 222** në adresën elektronike info@fzo.org.mk ose në web faqen zyrtare të Fondit **www.fzo.org.mk** tek pjesa Personat që realizojnë të ardhura të ulta.